



SHKOLLA
SI QENDËR KOMUNITARE



SHLUIJ "UNIVERSITETI
MARIN BARLETI"

Projekti:
**“Shkolla Komunitare”-Ekosistemi i
Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm**

MODULI
**“KURRIKULA DHE KOMPETENCA
E SIPËRMARRJES”**

Dhjetor, 2015

Në vend të hyrjes...

Paketa “Kurrikula dhe Kompetenca e Sipërmarrjes” është një material në ndihmë të nxënësve, mësuesve, prindërve dhe drejtuesve të shkollave, të përfshira në projektin “Shkolla Komunitare”- Ekosistemi i Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm”.

Ky produkt përmban trajtesa teorike dhe praktike që lidhen me kompetencën e sipërmarrjes, duke paraqitur dhe konceptime për të nga përvojat amerikane dhe evropiane, por dhe me mundësitë që kanë dy elemene të kurrikulës së gjimnazit për të kultivuar aftësitë sipërmarrëse të nxënësit, si: *Projektet kurrikulare dhe Shërbimi komunitar*.

Ky produkt synon të krijojë njohuritë dhe aftësitë e duhura, profesionale të stafet e shkollave, të prindërit, të mësuesit dhe nxënësit, për të stimuluar krijimin e kompetencës sipërmarrëse të nxënësit, duke e lidhur ngushtë këtë proces formimi me interesat e nxënësve dhe me nevojat e komunitetit.

Kjo paketë synon jo vetëm të lehtësojë shkollat në zhvillimin e projekteve kurrikulare, të llojeve të ndryshme të tyre nga nxënësit, nga mësuesit, por dhe nëpërmjet zhvillimit të shërbimit komunitar në forma të larmishme në mjediset, komunitetet dhe në institucionet lokale përreth shkollës ose brenda saj.

Ne synojnë të ngacmojmë shkollat me ide, risi dhe praktika të frytshme që synojnë formimin e aftësive sipërmarrëse të rinjtë, por ato kërkojnë një angazhim të madh të mësuesve dhe nxënësve, si dhe kanë nevojë për mbështetjen e prindërve, ndaj këto risi dhe praktika që sugjerohen në këtë modul iniciojnë marrëdhënie të ngushta, bashkëpunimi midis mësuesve, nxënësve dhe prindërve brenda orëve mësimore, por dhe nëpërmjet formave të ndërveprimit të nxënësve në mjedisin social, në të cilin ata do të kultivojnë kompetencën sipërmarrëse në komunitetin ku jetojnë, njohuri dhe aftësi që mund t’u vlejné gjatë gjithë jetës.

Përmbajtja dhe praktikat e këtij moduli do të jenë pjesë e veprimtarive të rrjetit të shkollave të përfshira në projektin e shkollës komunitare, ku ekipet e pedagogëve dhe specialistëve të Universitetit “Marin Barleti” (UMB) do të zhvillojnë seanca informuese dhe trajnimi me grupet e interesuara.

Ekipi i projektit në UMB.

Moduli: “Kurrikula dhe Kompetenca e Sipërmarrjes”

Synimi: Krijimi i aftësive të duhura profesionale për të zhvilluar kompetencën e sipërmarrjes te të rinjtë e shkollave të projektit.

Objektivat: Në fund të trajnimit pjesëmarrësit (nxënës, mësues dhe prindër) të jenë të aftë:

1. Të shpjegojnë se çfarë është sipërmarrja
2. Të shpjegojnë se ç’është kompetenca e sipërmarrjes sipas dokumentit zyrtar të BE-së
3. Të analizojnë përmbajtjen e kompetencës së sipërmarrjes nga cikli fillor deri në përfundim të shkollës së mesme, duke u bazuar në materialin e hartuar
4. Të shpjegojnë se ç’është një projekt kurrikular dhe pse ai ndihmon në krijimin e aftësive sipërmarrëse
5. Të emërtojnë llojet e projekteve kurrikulare
6. Të identifikojnë se ku mund të zhvillohen projekte kurrikulare, përveç shkollës
7. Të identifikojnë elementët e një projekti kurrikular
8. Të thonë ndryshimet midis projekteve kurrikulare që hartohen nga mësuesit dhe ato që hartohen nga nxënësit
9. Të zhvillojnë një projekt kurrikular në nivel shkolle që zhvillon aftësitë sipërmarrëse
10. Të zhvillojnë një projekt ndërlëndor në nivel klase që zhvillon aftësitë sipërmarrëse
11. Të përfshijnë prindërit në zhvillimin e projekteve që kultivojnë kompetencën sipërmarrëse
12. Të zhvillojnë një projekt kurrikular në ndonjë institucion publik ose jopublik të zonës ku është shkolla
13. Të shpjegojnë pse është i domosdoshëm shërbimi komunitar për krijimin e aftësive sipërmarrëse
14. Të analizojnë shërbimin komunitar që zhvillon secili nxënës
15. Të zbatojnë rekomandimet e modulit të hartuar për shërbimin komunitar
16. Të përfshijnë prindërit në vlerësimin e shërbimit komunitar
17. Të zbatojnë praktika të mira dhe të efektshme për projektet kurrikulare dhe shërbimin komunitar në gjimnaze dhe komunitetet ku jetojnë

Metodologjia: Prezantime, punë në grupe, lexim materialesh, punë individuale, stuhi mendimesh, diskutime të lira, komente dhe debate.

Pjesëmarrës: Mësues, prindër, nxënës

Koha e nevojshme: 2 seanca 90 minutëshe

Mjetet e nevojshme: Flipcharts, markera me 5 ngjyra, materiali i modulit i fotokopjuar për çdo pjesëmarrës, mundësi për ppt.

PËRMBAJTJA

I.Ç'ËSHTË KOMPETENCA E SIPËRMARRJES?

I.1.PËRSE DUHET EDUKIMI I “SIPËRMARRJES” ?

I.2.SI MUND TË PËRFSHIHET “SIPËRMARRJA” NË KURRIKUL?

I.3.MUNDËSI PËR PËRFSHIRJEN E “SIPËRMARRJES” NË SHKOLLË SI KOMPETENCË E ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE ?

II.PROJEKTET KURRIKULARE KRIJOJNË AFTËSI TË SIPËRMARRJES

II.1.HARTIMI I NJË PROJEKTI KURRIKULAR NGA NXËNËSIT

II.2.HARTIMI I NJË PROJEKTI KURRIKULAR NGA MËSUESI/T

II.3.LLOJET KRYESORE TË PROJEKTEVE KURRIKULARE

IV. SHËRBIMI KOMUNITAR KRIJON AFTËSI TË SIPËRMARRJES

V.LITERATURA E SHFRYTËZUAR:

VI.1. WEBLIOGRAFI

KURRIKULA DHE KOMPETENCA E “SIPËRMARRJES”

I.Ç’ËSHTË KOMPETENCA E SIPËRMARRJES?

*“ Sipërmarrësit nuk lindin, por ata bëhen të tillë
përmes përvojave të tyre jetësore”*

Prof. Albert Shapio Universiteti i Ohajos, SH.B.A

Dy dekadat e fundit në shumë vende evropiane po diskutohet shumë për një kompetencë që synon përgatitjen e të rinjve me njohuri, aftësi dhe qëndrime për sipërmarrjen. Aftësitë për këtë drejtim shikohen si një mundësi e mirë për t’i integruar të rinjtë natyrshëm dhe pa vështirësi në jetën “reale”, gjë që nënkupton se të rinjtë mund të vendosin të ndërtojnë vetë jetën e tyre, të marrin përsipër ta drejtojnë në mënyrë efektive atë, duke e kthyer në një proces zhvillues dhe fitues për veten. Këto aftësi të formuara gjatë shkollimit synojnë që ata të krijojnë bizneset e tyre, të themelojnë pa vështirësi punën e tyre në një mënyrë të suksesshme.

Në këtë kontekst sipërmarrja shihet si një prioritet në vendet me ekonomi të zhvilluara dhe arsimi padyshim luan një rol parësor në këtë drejtim. Edukimi i sipërmarrjes në shkollë synon që t’i përgatisë njerëzit, në veçanti të rinjtë për të qenë të përgjegjshëm, sipërmarrës individualë, në mënyrë që ata të bëhen të tillë ose mendimtarë të sipërmarrjes për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe për një jetë të qëndrueshme në komunitetin ku ata bëjnë pjesë.

Ky edukim nuk mund të bëhet vetëm me libra, por ai realizohet përmes përfshirjes në këtë proces të përvojave “të gjalla” jetësore, përmes të cilave ata mësojnë , provojnë të rrezikojnë, të menaxhojnë rezultatet e punës së tyre, por më kryesorja ata krijojnë aftësi dhe qëndrime të domosdoshme për jetë nga këto përvoja.

Disa studiues e lidhin sipërmarrjen me mundësitë që një individ ka për të krijuar një biznes të tij. Nuk është thjesht kjo. Sipërmarrja është një kompetencë kyçe, tërësore dhe e rëndësishme që përfshin brenda saj njohuri, aftësi dhe qëndrime të caktuara, të cilat mundësojnë që të rinjtë të përballojnë sfidat e shekullit të ri ku kemi hyrë.

Sipërmarrja është një mënyrë të vepruari, e cila krijon siguri dhe vazhdimësi në jetën personale, duke mundësuar që brezat e rinj të përballojnë me sukses konkurrencën e tregut, përballjen me sistemin e vlerave që krijon një shoqëri e hapur, demokratike.

Kjo tërësi aftësish dhe vlerash që individi duhet të mbartë nuk lidhet thjesht vetëm me themelimin e një biznesi personal, por është diçka më shumë .Ajo përfshin një tërësi njohurish dhe aftësish që përbëjnë një linjë të edukimit të sipërmarrjes, të tilla si:

- Aftësi për të njohur mundësitë personale nga secili individ
- Aftësi për të shfrytëzuar mundësitë e tij duke gjeneruar ide të reja dhe duke përdorur burime të domosdoshme

- Aftësi për të krijuar, për të vepruar, për të rrezikuar duke ndërmarrë një “aventurë” të re individuale
- Aftësi për të menduar në mënyrë krijuese dhe kritike

Përfitim nga edukimi i “sipërmarrjes” kanë të gjitha moshat që mësojnë në sistemin para-universitar. Atyre u duhen krijuar kushtet e nevojshme për të marrë njohuri në këtë drejtim në tërë lëndët shkollore, duke orientuar kështu një politikë të re edukimi, e cila natyrisht kërkon një pasqyrim profesional në kurrikulën e shkollore.

Po ç’është sipërmarrja e lirë si kompetencë që duhet fituar dhe përmbushur nga të rinjtë në shkollë?

Sipas një dokumenti bazë të BE-së , i cili shpall 8 kompetencat kyçe që arsimit bazë duhet të përfshijë në kurrikul deri në vitin 2010, sipërmarrja e lirë ka këtë përmbajtje të shprehur në përkufizimin për të, në njohuritë, aftësitë dhe vlerat që një nxënës duhet të arrijë, si më poshtë:

Përcaktimi i sipërmarrjes	Njohuritë e domosdoshme	Aftësitë	Vlerat
<ul style="list-style-type: none"> • Sipërmarrja e lirë përbëhet nga një komponent aktiv dhe një pasiv. Ajo përfshin së bashku tendencën për t’i drejtuar ndryshimet drejt vetes dhe aftësinë për t’i mirëpritur, mbështetur dhe përshtatur të rejtat e sjella nga faktorët e jashtëm. • Sipërmarrja e lirë përfshin marrjen e përgjegjësisë për veprimet personale, pozitive ose 	<ul style="list-style-type: none"> • Diskuton dhe shpjegon njohuritë dhe mundësitë e tij në mënyrë të vazhdueshme dhe në vijimësi duke identifikuar me përshtatshmëri nevojat personale, si dhe duke përmbushur veprimtaritë profesionale dhe ato të biznesit personal. 	<ul style="list-style-type: none"> • Aftësi për të planifikuar, organizuar, analizuar, për të bërë, për të përmbledhur, për të vlerësuar dhe regjistruar • Aftësi për hartimin dhe zhvillimin e një projekti • Aftësi për të punuar bashkërisht dhe me fleksibilitet si pjesë e një grupi • Të qenit i aftë për të identifikuar tek vetja pikat e forta dhe të dobëta • Aftësi për t’iu përgjigjur në 	<ul style="list-style-type: none"> • I disponueshëm për iniciativë • Demonstron qëndrime pozitive për ndryshimet dhe idetë e reja • I gatshëm për fusha ku mund të demonstrojë plotësisht aftësitë e sipërmarrjes në mjedise të tilla si në shtëpi, në punën e tij personale, si dhe në komunitetin ku ai bën pjesë.

negative, zhvillimin e një vizioni strategjik, vendosjen e objektivave dhe përmbushjen e tyre, si dhe të qenit i motivuar për të arritur diçka në jetë		mënyrë aktive dhe pozitive ndryshimeve <ul style="list-style-type: none"> • Aftësi për të vlerësuar dhe për të marrë parasysh rreziqet dhe kur ai është vetë në rrezik 	
--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--

I.1.PËRSE DUHET EDUKIMI I “SIPËRMARRJES” ?

Përgjigjja rreth kësaj pyetjeje mund të jetë shumë e gjatë. Mund të jepen me dhjetëra ide, por kundërshtimet për këtë pyetje do të jenë gjithnjë të dështuara, sepse përfitim nga ky edukim për individët, për komunitete të ndryshme, për shtete të ndryshme është gjithmonë i pamatshëm dhe i thellë. Këto përfitime përfshijnë çështje të tilla si:

- Edukimi i “sipërmarrjes” i frymëzon dhe motivon të rinjtë që njohuritë , aftësitë e krijuara në shkollë të dinë t’i vendosin në mënyrë të frytshme në funksion të vetes në botën reale.
- Edukimi i “ sipërmarrjes” përmirëson përmbajtjen e shkollës dhe i ndihmon të rinjtë që të arrijnë qëllimet dhe objektivat arsimore përmes një progresi dhe vlerësimi të vazhdueshëm individual
- Edukimi i “sipërmarrjes” mbështetet mbi në tubacion që sjell gjithmonë njohuri, vlera për të rinjtë duke krijuar qytetarë të matur dhe prodhimtarë të cilët kontribuojnë dhe përballojnë konkurrencën në nivel lokal dhe kombëtar.

Sipërmarrja është drejtimi kyç i çdo ekonomie tregu të një vendi ku sundon konkurrenca e lirë dhe vlerësimi real i sistemit të vlerave njerëzore, ekonomike, sociale dhe politike.

Krijimi i vendeve të shumta të punës në një shoqëri gjithmonë ka filluar nga bizneset e vogla të cilat janë krijuar nga sipërmarrjet individuale, ku shumë prej tyre më vonë janë kthyer në biznese të mëdha duke mundësuar punësim për një sasi të konsiderueshme njerëzish. Njerëzit sipërmarrës ndihen më të lirë në jetën e tyre, ata kanë një sistem vetëvlerësimi për veten dhe punën, duke u ndjerë kështu më të sigurtë dhe të kënaqur në jetë. Rezultat i kësaj është se shumë politikanë, liderë kanë patur gjithmonë në përvojat e tyre fillestare sipërmarrjen e lirë në ekonomi. Kultivimi i një kulture të sipërmarrjes është një mundësi shumë e mirë që të rinjtë të besojnë tek këto vlera dhe të kenë sukses në nivel lokal, shtetëror dhe global, ndaj qëllimi parësor i

edukimit të sipërmarrjes është që të përgatisë të rinj dhe të rritur të suksesshëm në një ekonomi të sipërmarrjes së lirë.

Edukimi i “sipërmarrjes” është një proces të nxëni gjatë gjithë jetës, që fillon që në shkollën fillore dhe progreson në të gjithë nivelet e arsimit, përfshirë dhe edukimin e të rriturve në punë. Hartimi i një dokumenti zyrtar që paraqet një kornizë të qartë për edukimin e “sipërmarrjes” duhet përdorur nga mësuesit për të ndërtuar objektiva, për të zhvilluar veprimtari të nxëni, të cilat synojnë aftësimin e të rinjve për të sfiduar vështirësitë për të zgjidhur problemet që dalin në jetë, për të përdorur përvojat personale nga jeta në funksion të mundësive të sipërmarrjes, si dhe të krijimit të një ekspertize për të menduar, krijuar dhe menaxhuar me sukses një biznes personal.

Prindërit janë shumë të interesuar që fëmijët e tyre të mësojnë në një shkollë të mirë dhe këtë e mendojnë vetëm duke stimuluar të mësuarit e lëndëve kyç si: gjuha amtare, gjuha e huaj, matematika. Po ashtu sot në Shqipëri një përqindje e konsiderueshme jeton me biznesin e vet dhe me mijëra të tjerë ëndërrojnë të kenë një sipërmarrje të tyre, një firmë, një kompani, një zyrë, që të jetojnë dhe të ndjehen “të lirë” në shoqëri.

Duke patur programe edukimi për sipërmarrjen në shkollë është një mundësi e mirë për t’i përgatitur të rinjtë për jetën, për nevojat që ata do të kenë në të ardhmen. Këto programe tashmë konsiderohen si ambicioze dhe tejet të domosdoshme në vendet perëndimore. Aq më shumë kjo bëhet e besueshme kur ndjehet dukshëm se të rinjtë pas shkollimit nuk gjejnë vende pune dhe aq më shumë nuk dinë se si të orientohen dhe të venë në shërbim të tyre formimin që ata kanë marë. Për më tepër ata nuk mendojnë të kenë “biznesin” e tyre. Po të pyesësh shumë studentë nga fusha të ndryshme formimi duket qartë mungesa e kompetencës së sipërmarrjes tek ata. Shumë studentë të ekonomikut nuk mendojnë të kenë një biznes të tyre pas përfundimit të studimeve universitare. Shumë studentë të mësuesisë nuk dëshirojnë të punojnë në këtë fushë pas përfundimit të shkollimit. Në fakt, kjo nuk është aq e thjeshtë po të mendosh trashëgiminë tonë politike, sociale dhe ekonomike ku gjithshka pritej nga “lart” për t’u emëruar dhe për të filluar një punë dhe iniciativa e lirë, sipërmarrja personale pothuajse nuk ekzistonte dhe nuk lejohej. Duke u nisur nga kjo trashëgimi dhe ky kontekst, sistemi i edukimit duhet të orientojë dhe programojë një sistem edukimi për sipërmarrjen.

Të formosh të rinj të aftë që të kenë ide origjinale, të cilat mund të kthehen në biznese dhe mënyra përfitimi për ta në përputhje me ligjet dhe rregullat e ekonomisë së tregut, duhet konsideruar si një përparësi e sistemit arsimor.

Sipërmarrja si kompetencë që duhet të arrihet nga nxënësit ngërthen brenda saj një tërësi njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash, të cilat pasqyrohen në përmbajtjen që ofrojnë gjithë kurrikulat lëndore sipas fushave shoqërore, shkencore, natyrore. Në këtë kontekst brenda aftësisë holistike të një sipërmarrësi është e domosdoshme të identifikohen mënyra të tilla sjelljeje si:

- Aftësia për të ndërtuar marrëdhënie me të tjerë
- Aftësia për të mbajtur lidhje të qëndrueshme
- Aftësia për të qenë gjithmonë rigoroz dhe “i rreptë” me veten dhe me të tjerët
- Aftësitë për bashkëpunuar me të tjerë, për të mbajtur lidhje të vazhdueshme me ta, si dhe për të patur një “disiplinë” personale janë qëndrime, të cilat kërkojnë një kohë të gjatë për t’u krijuar.

Ato janë rrjedhojë e një formimi të shëndoshë në fushën e shkencave natyrore, të shkencave shoqërore në shkollë, por më shumë rëndësi ka mjedisi ku jeton nxënësi që fëmijë deri në shkollën e mesme.

Të punuarit në grup, ndërtimi i marrëdhënieve me të tjerët, përballimi i situatave konfliktuale, përballimi i problemeve sociale, kulturore që ka grupi ku bën pjesë është një mundësi e mirë për të krijuar sjellje efektive bashkëpunimi. Studiuesit sugjerojnë se pjesëmarrja e fëmijës në grupe ku shfaqen dukshëm probleme të ndryshme sociale, ku ka probleme të marrëdhënieve u jep nxënësve forcë dhe mundësi për të krijuar aftësi bashkëpunimi të qëndrueshme në jetë. Një rol të rëndësishëm në këtë rast luan procesi i mësimdhënies dhe i të nxënit.

Një mjedis ndërveprues, bashkëpunues, stimulues është një mbështetje profesionale për të krijuar siguri tek vetvetja, për të qenë i hapur për bashkëpunime, për të mbajtur lidhje afatgjata, si dhe krijimi i një aftësive të duhura për të qenë gjithmonë kërkues, i disiplinuar brenda interesave personale. Të gjitha këto aftësi janë të domosdoshme kur bëhet fjalë për të formuar sipërmarrësit e lirë dhe të aftë për të përballuar ekonominë e tregut.

I.2. SI MUND TË PËRFSHIHET “SIPËRMARRJA” NË KURRIKUL?

*“Gjithkush ka qenë sipërmarrës një herë
në jetën e tij edhe pa e ditur një gjë të tillë”*
Bill Gates. Microsoft Sh.B.A

Krijimi i aftësive të sipërmarrjes arrihet përmes një procesi të gjatë të nxëni dhe vazhdon gjatë gjithë jetës. Edukimi i “sipërmarrjes” ka nevojë të përfshihet në të gjitha nivelet e shkollimit si dhe të mundësojë një integrim të natyrshëm të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që ajo synon në një sistem holistik brenda kurrikulës shkollore. Në këtë kontekst sipërmarrja nuk mund të konsiderohet si lëndë ose program i posaçëm shkollor, por ajo zhvillohet dhe përmbushet përmes një procesi afatgjatë që përfshin mosha të ndryshme të individit që i vogël deri sa të diplomohet dhe më tutje në profesionin që zgjedh të punojë. Ky proces përfshin një marrëdhënie të gjatë , e cila duhet bazuar në ndërveprimin aktiv midis mësuesve, edukatorëve dhe të rinjve, por më i rëndësishëm është stimulimi i një të nxëni që bazohet gjithmonë në punën në grupe, në përballimin e situatave dhe zgjidhjes së problemave, duke nxitur dhe krijuar një të menduar të thellë reflektiv dhe kritik , që bëhet i tillë, duke u bazuar në shqyrtimin dhe analizën e rasteve dhe situatave reale të jetës.

Një model i mëposhtëm paraqet disa faza të zhvillimit të edukimit të sipërmarrjes gjatë gjithë jetës

Faza e parë: Fillimi lidhet me formimin e nxënësve në arsimin bazë dhe në shkollën e mesme ku nxënësit duke u bazuar përvojën e tyre jetësore identifikojnë fakte dhe raste të zhvillimit dhe të ecurisë së biznesit dhe çështjeve të tregut. Në këtë fazë nxënësit mësojnë rreth elementëve bazë të ekonomisë, rreth mundësive për karrierë, për nevojat dhe aftësitë që duhen për të qenë si suksesshme në ekonominë e tregut të lirë. Motivimi për të nxënë në këtë drejtim dhe puna për të mbështetur mundësitë individuale të nxënësve në këtë periudhë janë rezultate të rëndësishme në këtë fazë, e cila u jep siguri për të ardhmen.

Faza e dytë: Të qenit i ditur/i informuar. Kjo fazë lidhet me shkollën e mesme dhe në këtë periudhë nxënësit mësojnë të flasin me gjuhën e biznesit dhe i shikojnë problemet nga pikëpamje e tregut dhe e biznesit. Një nevojë emergjente në këtë kohë konsiderohet edukimi teknologjik që lidhet me përdorimin e mjetet elektronike si kompjuteri, interneti, pajisje teknike etj. Në këtë fazë theksohet me forcë futja në orë të posaçme mësimore programi i edukimit të sipërmarrjes ose zhvillimi i kurseve të veçanta për sipërmarrjen.P.sh trajtimi i koncepteve dhe praktikave të tilla si:përdorimi i parasë në formën “kesh”, ankandet, shitjet, blerjet duhet të jenë pjesë e komunikimit profesional në klasë.

Faza e tretë: Aplikime/zbatimet krijuese. Biznesi është një çështje komplekse, por formimi dhe edukimi i të rinjve nuk e reflekton siç duhet këtë kompleksiteti. Formimi i doktorëve bëhet në shumë vite në universitet, por në jetën ekonomike ndodh që një biznes i vogël mund të mësojë të gjitha gjërat e nevojshme dhe të domosdoshme vetëm me trajnimin që u është mundësuar vetëm ditëve të shtuna nëpërmjet seminareve.

Në këtë fazë nxënësit duhet të kenë kohën e duhur për të eksploruar çështje të biznesit, llojet e ndryshme të tij si dhe si mund të planifikohet një biznes. Në këtë nivel ekziston një mundësi e mirë për të përsëritur dhe atë se çfarë është nxënë në nivelet ose fazat e mëparme. Në këtë fazë është e nevojshme që nxënësit të kenë qëndrime të konsoliduara për çështje te vendimmarjes dhe të planifikimit dhe arritjes së një biznesi.

Kjo fazë mund të zërë vend në programe të avancuara të shkollave profesionale nëpërmjet kurseve të posaçme ose dhe përmes 2-3 viteve studime në universitete. Qëllimi përfundimtar i kësaj faze është që të bëjnë të mundur që nxënësit ose studentët të bëhen sipërmarrës.

Faza e katërt: Fillimi i zbatimit në jetë i aftësive sipërmarrëse.

Pas formimit në edukim, duke marrë një profesion të caktuar fillon në mënyrë të natyrshme përvoja e punës. Shumë vetë fillojnë të krijojnë biznesin e tyre dhe në këtë kohë ata si fillestarë në biznes kanë nevojë për asistencë dhe këshillim.Në këtë rast mund të shfrytëzohen programe edukimi për komunitetin e biznesit, të cilat mund të

ofrohen nga shkolla profesionale, nga universitetet, ose nga projekte të ndryshme që zbatohen në fushën e krijimit të kapaciteteve njerëzore dhe mund të kenë programe trajnimi për sipërmarrësit.

Faza e pestë: Zhvillimi dhe vetëplotësimi si sipërmarrës.

Kjo fazë përkon me kohën kur të rriturit tashmë themelojnë biznesin e tyre dhe e menaxhojnë atë mjaft mirë.

Shpesh pronarët e bizneseve tërhiqen vetëm nga ideja e fitimit, por vonë ata kuptojnë që ka rëndësi dhe ndjekja e zhvillimeve të kohës dhe perspektivave në fushën ku ata punojnë jo vetëm në kontekstin lokal dhe kombëtar, por dhe në atë global, gjë e cila duhet të shoqëruar me një seri trajnimesh të stafëve dhe vetes për të reja dhe sidomos për zhvillimet teknologjike, të cilat ndryshojnë herë pas here dhe ndikojnë në cilësinë e prodhimit dhe të mallit që prodhohet.

Në përvoja të suksesshme perëndimore trajnimi i komuniteteve të biznesit, nga universitetet, ose organizimi i tyre në shoqata, në organizma të ndryshme, pjesëmarrja në panairë ose prania gjithmonë në media përmes reklamës dhe prezantimit është një mundësi e mirë për të qenë gjithmonë i informuar, për të marrë dhe për të shkëmbyer ide, të cilat e mbajnë një biznes gjithmonë në vijueshmëri, në progres dhe rezultate ekonomike.

Cfarë përmbajtje ofron kompetenca e sipërmarrjes?

Ka shumë ide dhe gjykime për përmbajtjen e kompetencës së sipërmarrjes. Përveç përcaktimit që kompetencat evropiane i bëjnë sipërmarrjes, ne mund të identifikojmë një larmi të standardeve të përmbajtjes dhe të arritjes për këtë koncept. Kështu një përcaktim i suksesshëm është dhe përmbajtja që ofron **Konsorciumi Kombëtar i Ohajos për Edukimin e Sipërmarrjes në Arsim**. Këto standarde konsiderohen të tilla, pasi janë provuar tashmë prej vitesh në sistemin e tyre arsimor. Standardet e hartuara nga ata përfshijnë tërë sistemin e edukimit që nga arsimi bazë deri në arsimin universitar. Më poshtë paraqitet një tabelë përmbledhëse, e cila fokusohet në edukimin e sipërmarrjes. Kjo përmbajtje ofrohet përmes 3 linjave madhore dhe nënlinjave që përmbledhen si më poshtë:

Nr	Linja	Nënlinjat	Konceptet (njohuri, aftësi qëndrime)	Fushat kurrikulare ku mund të trajtohet	Cikli shkollor ku mund të përfshihet
I	Njohuri dhe aftësi për sipërmarrjen	1-Proceset e sipërmarrjes	-Vendimmarrja -Pjesëmarrja -Problemzgjidhja -I gatshëm për të nisur një veprimtari personale	-Shkenca sociale -Shkenca natyrore	-cikli fillor -cikli i mesëm i ultë -shkolla e mesme

			-Iniciativë dhe kurajë -Preferencë për aventurë		
		2-Zhvillimi i konceptit si sipërmarrës	-Planifikimi i një pune personale -Përmbledhja e ideve dhe e një materiali -Identifikimi i mjeteve të domosdoshme për të kryer një punë të tij -Identifikimi i strategjive që vlejné për punën e tij -Vlerësimi dhe vetëvlerësimi i punëve personale -Planifikon lehtë një plan biznesi	-Shkenca sociale -Shkenca Natyrore -Arte -Teknologji	-cikli i mesëm i ultë -shkolla e mesme -shkolla e mesme profesionale
		3-Burimet e mbështetjes së sipërmarrjes	-Gjetja lehtësisht e mjeteve që i duhen për të nisur një iniciativë personale -Përcakton lehtësisht burimet financiare, burimet njerëzore për sipërmarrjen e tij -Vlerësimi i kostove financiare dhe përfitimeve nga sipërmarrja	-Shkenca sociale -Shkenca Natyrore -Teknologji	-cikli i mesëm i ultë -shkolla e mesme -shkolla e mesme profesionale
		4-Aktualizimi si sipërmarrës	-Biznes i vazhdueshëm -Nevojat e biznesit -Vlerësimi i rreziqeve dhe mundësive që ka sipërmarrje e tij -Përshtat ndryshime në sipërmarrjen e tij	-Shkenca sociale -Shkenca Natyrore -Teknologji	-shkolla e mesme -shkolla e mesme profesionale
		5-Përmbushja si sipërmarrës	-Shpjegon nevojat e sipërmarrjes së tij -vlerëson opsionet për të ardhmen -Planifikim i vazhdueshëm -Zhvillon strategji efektive për ecuri normale të biznesit të tij	-Shkenca sociale -Shkenca Natyrore -Teknologji	-shkolla e mesme -shkolla e mesme profesionale
II	Sjelljet sipërmarrëse	1-Drejtimi i sipërmarrjes	-Demonstron ndershmëri dhe integritet në drejtim -Demonstron sjellje të përgjegjshme -Demonstron iniciativë	-Shkenca sociale -Shkenca natyrore	-cikli fillor -cikli i mesëm i ultë -shkolla e

			<ul style="list-style-type: none"> -Demonstron etikë në veshje dhe komunikim -Zhvillon shpirtin e punës në grup -Drejton me qëndrime pozitive -Nxit të tjerët për të shprehur idetë dhe qëndrimet e tyre -Vlerëson diversitetin 		mesme -shkolla profesionale
		2-Vlerësimi i vetvetes	<ul style="list-style-type: none"> -Shfaq tipare dhe veçori dashamirëse për sipërmarrjen -Përcakton qartë interesat e tij -Vlerëson kapacitetet dhe mundësitë personale të tij -Lidhe mundësitë personale me vlerësimin e sipërmarrjes së tij 	<ul style="list-style-type: none"> -Shkenca sociale -Shkenca natyrore 	<ul style="list-style-type: none"> -cikli fillor -cikli i mesëm i ultë -shkolla e mesme -shkolla profesionale
		3-Menaxhimi personal	<ul style="list-style-type: none"> -Mban qëndrime pozitive -Demonstron entuziazëm dhe interes -Merr vendime -Zhvillon një ide dhe e orienton atë në një ndryshim -Demonstron aftësi të forta për zgjidhjen e problemave -Vlerëson rreziqet -Përdor kohën e punës me efektivitet -Zhvillon tolerancën dhe dykuptimësinë -Përdor feedback për arritjet e punës -Demonstron krijimtari në sipërmarrjen e tij -Vendos qëllime personale 	<ul style="list-style-type: none"> -Shkenca sociale -Shkenca natyrore 	<ul style="list-style-type: none"> -cikli fillor -cikli i mesëm i ultë -shkolla e mesme -shkolla profesionale -universitet
III	Gatishmëria	1-Themelimi i biznesit	<ul style="list-style-type: none"> -Shpjegon rolin e biznesit në shoqëri -Identifikon llojet e biznesit -Shpjegon rolin e menaxherit në një biznes -Përmbledh nevojat e biznesit të tij -Përcakton qartë rolet dhe detyrat në biznesin e tij 	<ul style="list-style-type: none"> Shkenca sociale -Shkenca natyrore - Teknologji 	<ul style="list-style-type: none"> -shkolla profesionale -universitet
		2-Veprimtaritë e biznesit	<ul style="list-style-type: none"> -Shpjegon qartë rolet e menaxhimit të produkteve të nxjerra -Harton një strategji të shpërndarjes 	<ul style="list-style-type: none"> Shkenca sociale -Shkenca 	<ul style="list-style-type: none"> -shkolla e mesme -shkolla

			<p>së informacionit për mallin që prodhon dhe publikimin e tij.</p> <p>-Demonstron profesionalizëm në komunikimin me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Stafin e biznesit • Etikën me komunikimin • Marrëdhëniet me të tjerët • Zgjidhjen e konflikteve 	<p>natyrore</p> <p>-</p> <p>Teknologji</p>	<p>profesionale</p> <p>-universitet</p>
		3-Aftësitë digjitale	<p>-Përdor saktë terminologjinë e kompjuterit</p> <p>-Aplikon programe të ndryshme në kompjuter</p> <p>-Përdor saktë ueb-et në kompjuter</p> <p>-Përdor programe të ndryshme që lidhen me çështje ekonomike</p> <p>-Përpunon të dhëna në kompjuter</p> <p>-Paraqet dhe përgatit raporte përmes mjeteve teknike</p>	<p>-Shkenca natyrore</p> <p>-</p> <p>Teknologji</p>	<p>-shkolla e mesme</p> <p>-shkolla profesionale</p> <p>-universitet</p>
		4-Koncepte ndërkombëtare për sipërmarrjen	<p>-Identifikon llojet e tregut ndërkombëtar</p> <p>-Identifikon interesat e tregut global</p> <p>-Shpjegon ndikimet kulturore dhe shoqërore në tregun botëror</p> <p>-Vlerëson influencën e huaj në tregun kombëtar</p>	<p>-Shkenca sociale</p> <p>- Shkenca natyrore</p>	<p>-shkolla e mesme</p> <p>-shkolla profesionale</p> <p>-universitet</p>
		5-Koncepte financiare	<p>-Përdorimi i parasë</p> <p>-Menaxhimi i parasë</p> <p>-Shërbimet financiare</p> <p>-Llogaritë financiare</p> <p>-Vlerësimi i punës</p> <p>-Menaxhimi i informacionit financiar</p> <p>-Mbajtja dhe regjistrimi i financave</p> <p>-Menaxhimi i tregut</p> <p>-Çmimi dhe shitja</p> <p>-Promovimi i produkteve</p> <p>-Sistemet e biznesit</p> <p>-Prokurimet</p> <p>-Veprimet ditore ne finance</p> <p>-Rreziqet financiare</p> <p>-Menaxhimi i rreziqeve</p>	<p>Shkenca ekonomike</p>	<p>-shkolla profesionale ekonomike</p> <p>-universitet</p>

			-Menaxhimi strategjik dhe ne perspektivë i biznesit -Kontrolli financiar		
--	--	--	--------------------------------------------------------------------------------	--	--

I.3. MUNDËSI PËR PËRFSHIRJEN E “SIPËRMARRJES” SI KOMPETENCË E ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE ?

Tërësia e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve lidhur me sipërmarrjen është e gjerë dhe tërësore. Kjo kompetencë ka nevojë që të vendosë në funksion të saj të gjitha kurrikulat lëndore.

Përfshirja e kompetencës së sipërmarrjes kërkon së pari:

- Identifikimin e të gjitha objektivave që kanë lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me sipërmarrjen në të gjitha përmbajtjen që ofrojnë shkencat sociale, natyrore, edukimi teknologjik, etj.
- Futjen e një sërë objektivash të reja ose rezultatesh mësimore që lidhen me këtë kompetencë në të gjitha lëndët e arsimit të detyruar dhe atij të mesëm.
- Përdorimin e rrugëve ekstrakurrikulare dhe kroskurrikulare për trajtimin e “sipërmarrjes”
- Bashkëpunimin me organizatat qeveritare dhe jofitimprurëse që kontribuojnë në drejtimin të sipërmarrjes
- Hartimin e udhëzuesve dhe materialeve burimore për mësuesit
- Trajnimin e mësuesve lidhur me zhvillimin e kompetencës së “sipërmarrjes” në nivel shkolle

Duke qenë në fillesa, ky proces kërkon një mbështetje të fort si nga politik bërësit, por dhe nga institucione të tjera që punojnë në këtë drejtim për të filluar një iniciativë të re, që lidhet ngushtë me të ardhmen e të rinjve në një shoqëri të hapur dhe që bazohet në vlerat e tregut.

II.PROJEKTET KURRIKULARE KRIJOJNË AFTËSI TË SIPËRMARRJES

Çfarë është një projekt kurrikular?

Projekti kurrikular është një përpjekje për t’i dhënë zgjidhje një situatë së cilës nxënësit nuk i gjejnë dot përgjigje të gatshme, dhe, për të cilën duhet të rrëmojnë në njohuritë e nxëna shkollore dhe përtej tyre. Projekti kurrikular përball një problem të pahasur më parë nga nxënësit.

Një projekt kurrikular nuk reduktohet në thjesht sistemimin e informacioneve të qëmtuara në tekstet shkollore dhe në burime të tjera. Thelbi i një projekti është origjinaliteti.

Një projekt për centralet bërthamore nuk mjaftohet me një shtjellim përmbledhës të informacioneve rreth këtyre centraleve. Duhet doemos edhe qëndrimi vetjak i nxënësve ndaj tyre.

Një projekt mbi ndotjen e ujit të pijshëm do të dilte i paarrirë po qe se do të rendiste vetëm karakteristikat e këtyre ndotjeve dhe dëmet përkatëse. Analiza kimike, natyrisht jo shteruese, e ujit të pijshëm të shkollës, do të përbënte origjinalitetin.

Mund të ndërmerret një projekt mbi parimet aerodinamike të avionëve, madje të kombinohet edhe me historikun e tyre, por konstruktimi modest i një modeli avioni do të ishte qendra e rëndësës së projektit.

Kahu i një projekti kurrikular është zbatimi i informacioneve. Niveli më i lartë i zbatimit është nxitja ose arritja e ndryshimeve përmirësues. Projekti për ujin e pijshëm mund të synojë ndërgjegjësimin komunitar përmes posterave ose/dhe debateve komunitare. Një projekt për llojet e trëndafilave mund të përfundojë me mbjelljen e tyre në shkollë.

- **Llojet e projekteve kurrikulare**

Projektet kurrikulare janë të paktën tre-llojesh.

Njëri i takon planit të shkollës. Secili nxënës, gjatë tre viteve të gjimnazit, duhet marrë pjesë në projekte të tilla në të paktën 18 orë mësimore.

Dy llojet e tjera i takojnë planit mësimor të mësuesit. Këto projekte llogariten në totalin e orëve të programit lëndor.

Mësuesi mund të zgjedhë projektin kurrikular si metodë për të shtjelluar **njohuritë e reja**. Projektet kurrikulare janë edhe pjesë e përhershme e **përpunimit të njohurive**.

Në projekte të tilla nxënësve nuk u kërkohet të mbajnë mend njohuri të reja. (Më poshtë trajtohet projekti kurrikular, në përgjithësi, dhe pastaj secili nga të tre llojet e tij)

Projektet kurrikulare mund të jenë thjesht lëndore ose më shumë se një-lëndore, mund t'i përkasin një fushe të nxëni ose të shtrihen në më shumë se një fushë.

Një projekt kurrikular zgjat disa ditë ose pak javë por edhe disa muaj.

Ato, zakonisht, mbyllen brenda një viti shkollor, por mund të shtrihen edhe më tej duke u rimarrë në një vit pasojës më thellë ose/dhe më gjerë.

Një projekt mund të merret përsipër vetëm nga një mësues ose më shumë se një.

Për projekte të caktuara, shkolla mund të kërkojë bashkëpunimin me organizma si OJF ose fondacione, në përgjithësi, organizime të shoqërisë civile, por edhe nga kompani biznesi. Atje ku ka shkolla të larta, projekte interesante mund të lindin e zbatohen me kontributin e tyre.

Është, në radhë të parë, meritë e drejtorisë së shkollës, ndërtimi i bashkëpunimeve me ta, por edhe mësuesit vetë duhet të përqipen të zbulojnë mundësi të tilla.

Në mes drejtorit të shkollës dhe përfaqësuesve të një organizmi të tillë nënshkruhet një marrëveshje ku saktësohen detyrimet e ndërsjella. P.sh. një projekt për lëndën e muzikës fare mirë mund të zhvillohet në bashkëpunim me një shoqatë kulturore. Edhe kur një organizatë merr përsipër zhvillimin e një projekti me nxënës të shkollës, përherë, një ose më shumë mësues janë të bashkë-përgjegjës në mirë-kryerjen e tij.

- **Bashkëpunimi midis mësuesve**

Mësues të lëndëve të ndryshme merren vesh të zhvillojnë një projekt kurrikular kur ndërthuren njohuri të lëndëve të tyre. Në paraqitjen e projektit të përbashkët përcaktohet edhe numri i orëve mësimore që secili nga mësuesit i llogarit në planin e vet mësimor.

Projektet ndër-lëndore, ku merr pjesë më shumë se një mësues, miratohen nga ekipi kurrikular i shkollës.

Projektet e para kurrikulare nuk janë të lehta për mësuesit pa përvoja të tilla. Shkëmbimi i mendimeve dhe përvojave me kolegët është ndjeshëm lehtësues. Ekipet (komisionet) lëndore të shkollës duhet të përfshijnë në planin e tyre takime të rregullta për zotërimin e kësaj mjeshtrie. Drejtoria e shkollës duhet të sigurohet se këto ekipe zhvillojnë takime të mira. Drejtoria duhet të planifikojë edhe takime periodike të mësuesve të një fushe të nxëni, edhe të krejt trupës pedagogjike, për problematikën e projekteve kurrikulare.

Përvoja e mësuesve në projekte veçanërisht të frytshme është një pasuri e shkollës. Shkolla duhet të krijojë arshivën e projekteve ku depozitohen projektet e mira. Mësuesit i shfrytëzojnë ato për gjatë viteve.

- **Roli i mësuesit**

Tema e një projekti kurrikular përzgjidhet nëpërmjet bashkëpunimit të mësuesve me nxënësit. Më e mira do të ishte që vetë nxënësit të ndërmarrin nisma për tema projektesh kurrikulare. Ata mundën ta bëjnë këtë me entuziazëm dhe zgjuarsiri kur mësuesi di t'i nxisë interesimin dhe krijimtarinë e tyre.

Sidoqoftë, mësuesi duhet të ketë një rezervë temash, ndër të cilat u lihet nxënësve të përzgjedhin.

Kur mësuesi përfshin edhe prindër në kërkimin e temave, sigurisht, larmia e tyre pasurohet, gjithashtu, shtohet mundësia e mirë realizimit.

Bisedat e posaçme me nxënës dhe prindër, pyetësorët me ta, janë boll të vyera për suksesin e projekteve kurrikulare.

Mësuesi kujdestar mund të hartojë listën e profesioneve të prindërve të nxënësve. Krijohet kështu një pasuri mundësish për të organizuar bashkëpunime në projektet kurrikulare. Ka mësues që e kanë bërë këtë për orët e lira. P.sh., në një projekt

kurrikular për SIDA-n, përveç veprimtarive të tjera, parashikohet edhe biseda me një mjek të specializuar, dhe nëse një i tillë është prind i një nxënësi të klasës, qoftë edhe të shkollës, vjen e u përgjigjet pyetjeve të nxënësve. Kur për prezantimin e një projekti do të duhet ndihmesa e një zdrukthari, një prind me këtë profesiona ndihmon nxënësit.

Mësuesi është lehtësues i veprimtarisë së nxënësve. Mësuesi, që nuk e zotëron rolin e lehtësuesit, rrezikon të bëhet gati një anëtar i grupit të nxënësve, madje, jo rrallë të paraqitet si kryetar i tij, madje më keq, të marrë përsipër t'u diktojë nxënësve se çfarë të bëjnë, u jep të gatshme informacione dhe përgjigje. Në këtë rast, nuk është kuptuar dobia e thellë e projektit kurrikular. Nxënësit dëmtohen.

Mësuesi, ruan gjysmë-largësinë, d.m.th. nuk u merr nga dora nxënësve atë që ata munden ta bëjnë vetë. Nxënësve u duhet bërë e qartë se përgjegjësia për suksesin e projektit u takon atyre, por mësuesi do t'u jetë pranë për çfarëdo pyetje a shqetësim. Asistenca e mësuesve ndaj nxënësve shkon sipas një kurbe zbritëse gjatë viteve sepse nxënësit duhet të forcohen me kalimin e kohës për punë të pavarur dhe vendime të pavarura. Është më intensive në klasën e 10-të kjo asistencë.

Mësuesi duhet t'i inkurajojë pareshtur nxënësit. Entuziazmi i nxënësve duhet të ruhet në nivel konstant që nga fillimi deri në fund dhe, si rregull, është entuziazmi i mësuesit, që transferohet tek ata.

Nxënësi lipset të vështrojë anët pozitive të veprimtarisë së grupit dhe të çdo nxënësi dhe t'i përmendë vazhdimisht ato. Gabimet e nxënësve, përveç atyre disiplinore, si respektimi i afateve pse prishja e qetësisë gjatë punës me projektin, nuk duhen qortuar. Nuk ka më të natyrshme se gabimet ndërsa je duke nxënë, veçanërisht në punë të tilla komplekse dhe me disa bashkëpunëtorë si projektet kurrikulare.

Detyra e mësuesi ose e grupit të mësuesve është të:

- Të planifikojnë dhe realizojnë orët mësimore të projektit;
- Të lehtësojnë nxënësit në menaxhimin e projektit;
- Të vëzhgojnë mirë-kryerjen nga nxënësit të veprimtarive të planifikuara;
- Të vlerësojnë nxënësit.

Koha e punës e mësuesit për këto lloj projektesh përfshihet në ngarkesën zyrtare mësimore të tij.

II.1.HARTIMI I NJË PROJEKTI KURRIKULAR NGA NXËNËSIT

• Ndarja e detyrave në mes nxënësve të një grupi

Në projektet, që ndërmerren nga grupe nxënësish, ka një kombinim të punës në grup me atë individuale. Të dyja janë po aq të domosdoshme për t'u kultivuar.

Ndarja e mirë e punëve ndërmjet anëtarëve të grupit paralajmëron mirë ecurinë e mbarë të projektit. Është me mjaft rëndësi që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe të ndjehet i dobishëm, i pazëvendësueshëm. Kontributet do të jenë të ndryshme, por serioziteti i nxënësve duhet të jetë i njëjtë. Nxënësit ndryshojnë nga njeri-tjetri, por më shumë për nga talentet ndaj një projekti. Secilit i do gjetur prirja vetjake. Dikush pëlqen më shumë të kërkojë në internet për informacione, një tjetër është më i zoti në dizenjimin e fletë-palosjeve, një tjetër për intervista të mira, kurse dikush i ka duart të shkathëta.

Më e dëshiruara është që vetë nxënësit të ndanin detyrat ndërmjet tyre, por shpesh kështu nuk ngjet ndarja më e qëlluar, sidomos kur mungon përvoja. Veçanërisht në projektet e para, mësuesi duhet të ketë rol të ndjeshëm në përcaktimin e qartë të kontributeve të secilit nxënës. Dora-dorës që nxënësit ambientohen me projekte, ata duhet të stërviten me ndarjen e punëve, si një cilësi që u vlen më larg nga koha e shkollës.

Si rregull, një punë grupi me pak nxënës e do një drejtues. Mësuesi nuk e emëron atë, por e synon. Nuk është e thënë që të jetë nxënësi me rezultate më të larta mësimore. Shpesh të tjerë janë më karizmatikë, d.m.th. edhe më të pranueshëm nga bashkënxënësit, prandaj pëlqimi i pjesëtarëve të grupit ka vlerë.

Një projekt, ku përfshihet e gjithë klasa ose një numër i madh nxënësish, zakonisht, copëtohet në nën-projekte. Klasa ose grupi i madh ndahet në grupe të vegjël nxënësish dhe secili prej tyre merr përsipër një nën-projekt. Sidomos në fillimet, përballohet më mirë një projekt i vetëm për të gjithë klasën.

1.Përcaktimi i objektivit (objektivave)/rezultateve

Secili nxënës duhet të ketë mjaft të qartë se cili është objektivi i projektit. Objektivat janë përherë të matshme dhe përshkruajnë rezultatin e përpjekjeve të përbashkëta. Përherë projekti ka produkt përfundimtar. Gjithashtu, për secilin nxënës duhet të jetë i saktësuar objektivi i tij, d.m.th. cili do të jetë kontributi i tij i matshëm.

2.Plani i projektit

Plani i projektit përshkruan se si do të përmbushet objektivi i tij. Nxënësit hartojnë një plan të projektit, i cili përmban veprimtaritë, personat-përgjegjës dhe afatet. Nëpërmjet planit, secili nxënës saktëson detyrat e tij, që do të thotë se, përveç planit tërësor të projektit, është edhe plani vetjak i secilit nxënës. Ndër të tjerat, plani i projektit duhet të parashikojë takimet e përbashkëta të grupit të nxënësve, me ose pa mësuesin. Këto takime janë të domosdoshme për të mbajtur kohezionin e grupit.

Të hartosh një plan nuk është asnjëherë e lehtë edhe për të rriturit. Nga nxënësit kërkohet që të stërviten për të hartuar plane të mira. Metoda është “të nxënit duke bërë” dhe “të përparuarit duke gabuar dhe ndrequr dora-dorës gabimet”.

3.Buxheti

Buxheti i projektit është një nga zërat e planit. Projekti, si rregull, duhet të ketë sa më me pak shpenzime nga shkolla dhe, sidomos, duhet të shmangen shpenzimet nga prindërit e nxënësve. Nxënësit përfshihen në disa projekte gjatë një viti shkollor dhe t'u kërkosh prindërve të shpenzojnë për to, është një formë pakujdesie deri në abuzim. Është drejtorja e shkollës, veç mësuesit, që mban përgjegjësinë për shpërdorime të tilla.

Kur një projekt i duhen disa shpenzime nga shkolla ose/dhe nga nxënësit, duhet miratohen nga ekipi kurrikular, i cili, nga ana e tij, do të duhet të kërkojë miratimin e bordit të shkollës.

4.Raporti përfundimtar

Për një projekt hartohet nga nxënësit një raport përfundimtar me shkrim. Raporti përmban një parashtrim teorik, d.m.th. përshkruan shkurt njohuritë kryesore që janë përdorur në projekt. Në të përshkruhen përmbledhtas veprimtaritë kryesore, çështjet mbizotëruese dhe gjetjet më të rëndësishme. Një listë e burimeve të informacionit është gjithmonë pjesë e këtij raporti

Një rubrikë e përhershme e raportit është vetëvlerësimi. Çfarë shkoi mirë, çfarë jo dhe aq mirë? Pra, anët e forta dhe ato të dobëta. Sikur të niste tani nga e para, çfarë do të ndryshonin?

Ky raport i dorëzohet mësuesit. Bashkë me të i dorëzohet portofoli i projektit.

6.Portofoli i projektit përmban:

- Planin e projektit,
- Planet vetjake të nxënësve
- Shënimet gjatë takimeve të grupit,
- Një listë të burimeve të informacionit,
- Raportin përfundimtar,
- Të tjera që nxënësit dëshirojnë, si fotografi, episode interesante gjatë punës, etj.

Përveç raportit, nxënësit dorëzojnë dhe produktin e projektit kur nuk është thjesht raporti.

7. Prezantimi

Çdo projekt ka një epilog dhe ky është thuajse gjithmonë para një audience. Nxënësit e klasës janë përherë pjesëmarrës. Sipas përmasave ose interesit ndaj projektit, ka edhe të ftuar, prindër, mësues, nxënës të klasave të tjera, etj. Të gjithë kanë të drejtën të pyesin.

Të prezantuarit nxit mirë motivimin e nxënësve. Kur barra e prezantimit nuk i ngarkohet vetëm një nxënësi, sikundër do të duhej më shpesh, motivimi dhe përgjegjësia shumëfishohet.

Prezantimi është gojor, por, sipas veçorive të projekti, shoqërohet me albume, postera, video, etj. Përherë është e dëshirueshme që të vihen në punë zotësitë e nxënësve në fushën e TIK-ut.

Ka projekte që mbyllen me një debat në mes dy grupe nxënësish të së njëjtës klasë rreth një pyetje qendrore për të cilën të dyja grupet mbajnë dhe argumentojnë qëndrime të ndryshme, deri në të kundërta. Përgatitja për këtë debat është edhe puna kryesore e këtyre lloj projekteve.

Një ditë ceremoniale e shkollës posaçërisht për projektet mund të kthehet në traditë. Atë ditë ekspozohen projektet më të arrira për një publik më të gjerë.

E rëndësishme është që prezantimit t'i rezervohet kohë e mjaftueshme.

- **Rreziqet e mundshme në një projekt**

Projektet kurrikulare variojnë shumë për nga pretendimet. Mësuesi është përballë dilemës ndërmjet dëshirës dhe mundësisë. Është fjala për mundësitë e tij dhe të nxënësve të tij.

Nuk janë të këshillueshme tema tepër të mëdha projektesh, sikundër janë hasur te disa orë të lira. P.sh. “Zhvillimi qytetit tonë” është një multi-projekt, i cili, ndonëse ka meritën se kombinon një numër shumë të madh njohurish lëndore, ka të metën se është tepër i gjerë për shpatullat e nxënësve, edhe të mësuesve. Veçanërisht, në përvojat e para të mësuesve dhe të nxënësve duhet nisur me projekte modeste. Kompleksiteti ndërlikohet gjatë viteve, po ashtu thellësia e shqyrtimit të një çështje.

Përgatitja më shumë për një shfaqje publike, ku përkujdesja është më shumë që të lihet mbresë para shumë të ftuarve, se sa për një punë serioze mbi një ose disa lëndë, është përherë një rrezik i pranishëm, dhe bie në sy kur përzgjidhen projekte “madhështore”. Është përgjegjësia e ekipit kurrikular të filtrojë projektet dhe të skartojë ato që janë të përcipta.

Nuk duhet të mos përfillen projekte të vogla vetëm sepse mund të japin përshtypjen se mësuesi shmang ngarkesën e projekteve të mëdha. Përkundrazi, një projekt me një temë të kufizuar mundet që të zhvillohet më qartë dhe më me përfitim nga nxënësit.

Një rrezik tjetër është planifikimi i tepër pak orëve për një projekt, aq sa, pastaj, punët ecin me ngut, përciptas dhe, sidomos, nuk ka kohë të mjaftueshme për prezantimin e projektit.

Ka pasur raste kur për një projekt kurrikular është marrë një ekskursion dhe vetëm kaq. Ekskursioni nuk është qëllim, por është mjet i një projekti kurrikular dhe vetëm atëherë kur është kreu i domosdoshëm. Një ekskursion është pjesë e një projekti vetëm kur ka për qëllim grumbullimin e një informacioni përmes vëzhgimeve, fotografimit, koleksionimeve, etj. Nga ana tjetër, këto vëzhgime, fotografime, koleksionime, etj. kryhen vetë nga nxënësit në rrethinat e zonës. Ekskursionet, diku larg zonës së shkollës, u përkasin veprimtarive ekstra-kurrikulare.

Rreziku më i dendur gjatë punëve në grupe është simbioza ndaj “më të mirëve”. Veçanërisht nxënësit me vështirësi të nxëni lihen mënjanë dhe dëmtohen kështu edhe më shumë se sa gjatë orëve të tjera mësimore. Në raste të tilla projekti nuk ja ka arritur qëllimit. Mësuesit i duhet të vigjëlojë.

II.2.HARTIMI I NJË PROJEKTI KURRIKULAR NGA MËSUESI (MËSUESIT)

- **Objektivat/Rezultatet**

Mësuesi ose mësuesit hartojnë planin e tyre të projektit kurrikular, i cili ka ndryshime nga ai i nxënësve.

Kur bëhet fjalë për objektivat, do të renditen objektivat që mësuesit synojnë tek nxënësit e tyre. Të përbashkëta për të gjitha llojet e projekteve kurrikulare janë objektivat për aftësitë dhe qëndrimet e nxënësve.

Nxënësi ushtrohet të kërkojë burime të ndryshme informacioni, t’i krahasojë me frymë kritike, të veçojë ato që i shkojnë përshtat projektit. Është aftësia e menaxhimit të informacionit, që i vlen shumë në vitet e shkollës, por, po të ngulitet mirë, është e çmuar gjatë gjithë jetës.

Vetë debatet në mes nxënësve të grupit dhe përpara audiencës, u mprehin aftësinë e mendimit logjik dhe analitik (kritik). Nga ana tjetër, bashkëpunimi në grup përpunon aftësi të rëndësishme të komunikimit të cilat i hyjnë në punë në shkollë por shumë tepër në jetën pas shkollës. Shkurt bëhet fjalë për të nxënësit gjatë të gjithë jetës dhe për qëndrime gjatë të gjithë jetës.

Në varësi nga projekti, disa aftësi ushtrohen më shumë se të tjerat dhe, sidomos për to, mësuesi duhet të shkoqisë më imtë se ku kërkon të arrijë jkonkretisht me nxënësit e tij.

Rreziku në këto lloj objektivash është të shkruarit me terma të përgjithshme, gati si slogane, përherë njësoj në çdo projekt dhe shkaku është mungesa e përvojës ose/dhe e trajnimit. P.sh. “Të përmirësojnë prezantimet me gojë” është një “objektiv-slogan”, prej të cilit nuk rrjedh asnjë përgjegjësi për rezultatin, si nga nxënësit, ashtu dhe nga mësuesi.

- **Një format i parashtrimit të një projekti**

Mësuesi ose grupi i mësuesve të një projekti e përshkruajnë projektin pak a shumë sipas një formati, ku janë të domosdoshme këto rubrika:

- Titulli i projektit
- Objektivat/rezultatet e projektit
- Një listë me njohuritë kryesore lëndore të cilat do të përvetësohen ose rimerren në sajë të projektit
- (Nëse në një projekt merr pjesë më shumë se një mësues) Kontributi i çdo mësuesi dhe sa orë mësimore i takojnë secilit.
- Partnerët, nëse ka (prindër, OJF, etj.)
- Numri i nxënësve që përfshihen në projekt ose numri i klasave
- Përshkrimi përmbledhës i veprimtarive kryesore përkatëse, i ndarë në hapat kryesore, me afatet dhe përgjegjësit (kur ka dy a më shumë mësues)
- Burimet kryesore të informacionit
- Përshkrimi i produktit të projektit
- Tematika e secilës orë mësimore në kuadrin e projektit (Në disa raste, kur projekti zgjat, është e pamundur të parashikohen zhvillimet e tij, pra, një pjesë e këtyre temave lihen bosh)
- Mënyra e vlerësimit të nxënësve

Në disa raste hasen projekte kurrikulare me një numër tepër të madh faqesh të cilat janë të mbushura me fraza të përgjithshme. Është një shpenzim i padobishëm i kohës së punës. Parashtrimi i një projekti është skematik.

Ka mësues që harrojnë ose nuk i kushtojnë mjaft rëndësi rubrikës “Një listë me njohuritë kryesore lëndore të cilat do të rimerren në sajë të projektit”. Është një rubrikë tejet e domosdoshme dhe duhet shkoqitur mirë se për cilat njohuri bëhet fjalë.

- **Plani i orës mësimore/Ditari**

Mësuesi hedh në ditarin e tij përmbajtjen e orëve mësimore që u përkasin projekteve kurrikulare, po ashtu si bën me orët e tjera mësimore. Të gjitha orët, që i takojnë një projekti, duhet të vijjnë njeri pas tjetrit, temë pas teme. Këto duhet të jenë më vete në fletoren e ditarit.

- **Menaxhimi i informacionit**

Teksti i nxënësit është një burim i çmuar informimi por nuk është i vetmi. Teksti është një burim veçanërisht i rëndësishëm informacionit për mësuesin dhe nxënësit, por i pamjaftueshëm për përmbushjen e synimeve të kurrikulës së gjimnazit.

Te projektet është tejet e domosdoshme të shkohet “përtej tekstit”, dhe është përherë një nga objektivat e tyre stërvitja e nxënësve në kërkimin e informacioneve nga burime të tjera dhe sa më të larmishme. Shkolla rreh të ngjizë “in vitro” një mendje e cila “in vivo” do të jetë e zonja të nxërë gjatë të gjithë jetës duke përzgjedhur ndër informacionet alternative në mënyrë kritike dhe pragmatike.

Mësuesi duhet të këmbëngulë që nxënësit të përdorin burime të ndryshme informacioni.

Teksti shkollor i asaj klase, sigurisht, është një burim i dorës së parë. Projekti duhet ta shtrëngojë nxënësin ta shfletojë për të veçuar çka i duhet. Dhe jo vetëm atë, por edhe tekstet e klasave paraardhëse dhe, kur projekti është ndër-lëndor, edhe tekstet e të gjitha lëndëve përkatëse. Mësuesi nuk do ta anashkalojë kurrsesi këtë shans të vyer për nxënësit.

Kërkimi në internet, më shumë në kabinetin e TIK-ut, puna në bibliotekën e shkollës dhe në atë të qytetit, edhe në bibliotekat familjare, në medien e shkruar dhe atë vizive – ky është rekomandim këmbëngulës i mësuesit. Orë të caktuara të projektit mund të zhvillohen në kabinetin e kompjuterëve.

Përtej informacioneve të shkruara, duhet të jenë thuajse të përhershme informacionet “e gjalla”, d.m.th. përmes bisedave me specialistë, zyrtarë, dëshmitarë ngjarjesh, me prindërit ose të afërmit e të tjerë në komunitetin shkollor a më larg. Nxënësit mund të shkojnë t’i takojnë ata në vendin e tyre të punës, por këta mund të ftohen në klasë.

Gjithashtu, vizitat në muzeume, ekspozita, institucione qeveritare ose private, në kompani biznesi, vende me interes historik ose çfarëdo interesi tjetër, duhen rekomanduar si mundësi e madhe e informacioneve plotësuese.

Vetëm duke u konsultuar me informacione nga burime të ndryshme, nxënësit nisin e i krahasojnë të dhënat e tyre dhe kultivojnë qëndrimin kritik.

Mësuesi i ndihmon nxënësit të ushtrohen në mbajtjen shënimeve ndërkohë që grumbullojnë informacione.

Veçanërisht gjatë projekteve kurrikulare mësuesi shërben edhe si person burimor, veç jo në kuptimin që ai që u jep informacionet nxënësve, por i orienton kah burimet e duhura, thjesht për t’i pakësuar humbje të panevojshme të kohës. Ai edhe mund të

sugjerojë ndonjë libër që i shkon plotësisht përshtat projektit ose ndonjë adresë ku nxënësit është mirë të shkojnë, etj.

- **Vlerësimi i nxënësve nga mësuesi**

Secili nxënësit duhet të ketë mirë të qartë nga mësuesi (mësuesit) se si do të vlerësohet për punën e tij në një projekt, d.m.th. se çfarë do t'u vlerësojë atyre me notë, por edhe sipas cilave kriterëve. Veç kësaj, nxënësit duhet t'i jepet mundësia të bindet për drejtësinë dhe saktësinë e vlerësimit të mësuesit.

Secili nxënës, i përfshirë në një projekt, plotëson, dora-dorës, portofolin e projektit, i cili, përmban, sipas rastit, shënimet kryesore, që nxënësi mban, fotografi, fragmente të literaturës së konsultuar dhe, aq më mirë, përmbledhje të informacioneve të grumbulluara, etj. Ky portofol është, gjithashtu, një burim vlerësimi nga ana e mësuesit.

Vlerësimi i punës së nxënësve në një projekt kryhet nga disa pikëvështrime.

Këto janë:

- **Plani i projektit**

Sa qartë e kanë përshkruar nxënësit objektivin (objektivat) e projektit?

A kanë hartuar një plan të mirë? (A janë shpërndarë punët në mes nxënësve sa që secili të ketë për të bërë punë individuale? A janë parashikuar takime të grupit?)

- **Zbatimi i planit**

Sa i respektojnë afatet? A është përmirësuar plani gjatë zbatimit?

- **Menaxhimi i informacionit**

Sa shterues është kërkimi në tekstet shkollore? Sa të larmishme janë burimet e informacionit? A kanë mbajtur shënime nga informacionet? A mbahet qëndrim kritik ndaj informacioneve?

- **Etika e punës në grup**

A punojnë që të gjithë nxënësit? Mos mbizotëron një pakicë në kryerjen e punëve? Po në diskutimet?

A arrijnë në kompromise? A sillen me takt ndaj njeri-tjetrit?

A sjellin argumente gjatë diskutimeve? A janë bindëse?

- **Raporti përfundimtar**

*A ka ide origjinale? [Nuk ka rëndësi nëse mësuesi është i një mendje me konkluzionet. E rëndësishme është që të jenë të argumentuara.]
A është strukturuar qartë raporti?
Si është vetëvlerësimi?*

▪ **Prezantimi**

A është i qartë? A është tërheqës? A përfshihen në prezantim disa nxënës?

• **Të tjera që ndikojnë në vlerësimin e mësuesit me notë:**

- *A mos ka raporti pjesë të kopjuara? Kopjimi e ul notën menjëherë.*
- *A është e saktë gjuha e shkruar? A është shkruar me stil tërheqës?*

Ka dy mënyra të vlerësimit me notë të nxënësve për një projekt.

Njëra është: Të gjithë pjesëtarët e një grupi vlerësohen me të njëjtën notë. Në grup mundet të qëllonjë edhe nxënës simbiotikë ose edhe mospjesëmarrës. Ideja është që i takon vetë grupit të mirë-organizojë punët dhe të nxisë secilin të kontribuojë. Nëse nuk e arrin plotësisht, është e metë e grupit në tërësi.

Mënyra tjetër: Secili nxënës ka notën e vet e cila del përmes ponderimit të notës si grup dhe notës si individ. P.sh. notë si grup peshon 80%, kurse si individ 20%.

Nota si individ bazohet në vëzhgimet e mësuesit, sidomos gjatë orëve mësimore, dhe portofolit personal të nxënësit.

Mësuesi gjykon vetë cilën mënyrë të përdorë, por nuk duhet kurrsesi të ulë shume peshën e vlerësimit si grup. Një nga synimet e përhershme të projekteve kurrikulare është të edukojë qëndrimet e mira gjatë bashkëpunimit në grupe të vogla si një parapërgatitje për sjelljen e duhur në grupet e vogla të jetës si familja dhe vendi i punës.

Më poshtë është një udhëzues për vlerësimin në projektet kurrikulare. Ndarja është në katër nivele të cilat i korespondojnë:

Niveli pakalues	Nota “4”
Niveli bazë	Notat “5 dhe 6”
Niveli mesatar	Notat “7 dhe 8”
Niveli i lartë	Notat “9 dhe 10”

Nivelet	Kriteret
Pakalues	Nuk paraqitet raporti dhe nuk dorëzohet produkti (kur ka të tillë) Ose Raporti ka gabime të shumta për sa i përket njohurive. Mungojnë argumentet. Nuk ka bashkëpunim në grup. Nuk janë respektuar afatet.
Bazë	Pak burime informacioni. Kopjime nga informacionet. Pak argumente.

	Nxënësit përpiqen të bashkëpunojnë. Përgjithësisht janë zbatuar afatet. Raporti me gabime gjuhësore dhe i pastrukturuar. Prezantimi i përciptë.
Mesatar	Disa burime informacioni. Përpunim i mirë i informacioneve. Argumente të mira. Të përpiktë në afatet. Nxënësit bashkëpunojnë. Parashtrimi me shkrim me pak gabime gjuhësore dhe i strukturuar mirë.
I lartë	Larmi burimesh të informacionit. Gjykime kritike ndaj informacioneve. Ide origjinale. Të gjithë nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur dhe në grup. Parashtrimi me shkrim korrekt dhe i strukturuar mirë.

- **Përzgjedhja e projekteve**

Kur mësuesi ose disa mësues bashkë shqyrtojnë idetë për projektet e mundshme, do të duhet të analizojnë projektin nga disa pikëvështrime. Po këtë duhet të bëjë ekipi kurrikular i shkollës.

Nuk është e thënë që për një projekt të gjitha pyetjet e mëposhtme të kenë përgjigjen “po”. Tabela bën të mundur një “skanim” të projektit.

ASPEKTET	PYETJET	Po/Jo
Vështirësia	A është i realizueshëm për nxënësit?	
Njohuritë shkollore	A përdoren njohuri nga lënda e këtij viti shkollor?	
	A përdoren njohuri nga lënda në vitet e mëparshme shkollore?	
	A përdoren njohuri nga disa lëndë që zhvillohen në këtë vit shkollor?	
	A përdoren njohuri nga disa lëndë që zhvillohen në këtë vit shkollor?	
	A përdoren njohuri nga disa lëndë që zhvillohen në vitet e mëparshme shkollore?	
	A përdoren njohuri matematike?	
	A përdoren njohuri të TIK-ut?	
Burime të tjera informacioni	A parashikon projekti përdorimin e informacionit nga libra të tjerë?	
	A parashikon projekti përdorimin e informacionit nga media e shkruar?	
	A parashikon projekti përdorimin e informacionit nga media vizive?	
	A parashikon projekti kërkimin elektronik të informacioneve?	
	A parashikon projekti takime me persona burimorë?	
	A parashikon projekti vëzhgime të nxënësve të situatave reale?	
Tema e projektit	A ka të bëjë projekti me situata nga jeta reale?	
	A parashikon projekti ndërjegjësimin e nxënësve, të komunitetit, të publikut mbi një çështje?	
	A “zgjidh” një problem që ndeshet në jetën e përditshme?	

	A merr kohë të konsiderueshme puna në terren?	
	A parashikon projekti eksperimente?	
Aftësitë	A zhvillon të menduarit logjik të nxënësit?	
	A zhvillon të menduarit kritik të nxënësit?	
	A zhvillon aftësitë komunikuese të nxënësit?	
	A zhvillon aftësitë organizuese dhe menaxhuese të nxënësit?	
	A zhvillon aftësitë e nxënësve për punën në grup?	
	A nxit aftësitë krijuese të nxënësit?	
	A stërvit nxënësit të mbajnë qëndrime etiko-sociale?	

II.3.LLOJET KRYESORE TË PROJEKTEVE KURRIKULARE

- **Projektet kurrikulare të planit shkollor**

Është fjala për mbushjen, nga secili nxënës, e të paktën 36 orëve gjatë gjimnazit, me projekte të ndër-fushave të të nxënësve.

Një veçori e një projekti të tillë është që ndërmerret përtej një klase të vetme.

Përfshihet e gjithë shkolla, ose një projekt i caktuar merret përsipër nga paralelet e një klase apo të dy klasave (p.sh. 10-të dhe 11-të).

P.sh., nëse tema e projektit do të ishte “Ndotja në zonën tonë”, mund të zërthehet në në-tema në mes klasave, d.m.th. në fusha të veçanta “ekspertize”. Të tilla nën-tema mund të jenë: “Legjislacioni ekzistues për mbrojtjen nga ndotjet”, “Ndotja akustike në zonën tonë”, “Ndotja e ajrit” ose “Kompanitë e biznesit që shkaktojnë më shumë ndotje”, etj.

Veçoria tjetër është tema e projektit, d.m.th. problemi që shtrohet për kërkim dhe zgjidhje. Tema është komplekse, p.sh. “Respektimi i të drejtave të fëmijëve në qytetin (komunën, etj.) tonë”, “Bashkëpunimi i shkollës me komunitetin”.

“Integritim” është fjala-kyç, në përgjithësi për projektet kurrikulare, por tani niveli i integritimit është më i larti pasi duhen prekur doemos shumë fusha të nxënësve, madje, po të jetë e mundur, të mos lihen fusha të nxënësve pa u përfshirë.

Në projekte të tilla nuk duhet asnjëherë të mungojnë zbatimet që sjellin përmirësime në shkollë ose në komunitetin rreth shkollës, edhe më gjerë. Projektet për komunitetin dhe me komunitetin janë të parapëlqyera.

Më fort se në projektet kurrikulare të trupëzuara në programet lëndore, bashkëveprimi me partnerë jashtë shkollës është ajo që duhet bërë sa më mirë. Në radhë të parë, prindërit, përfaqësues nga organizma qeveritare dhe joqeveritare lokale.

Kërkimi i temave të përshtatshme kryhet më shumë nga ekipi kurrikular i shkollës. Ky mbledh sugjerimet nga mësuesit, nxënësit, prindërit, doemos nga përfaqësues të qeverisë lokale, gjithashtu heton mundësitë e bashkëpunimit me organizma qeveritare

dhe joqeveritare. Ekipi kurrikular ja rekomandon temat drejtorit të shkollës, kurse drejtori pret miratimin dhe kontributin e bordit të shkollës.

Një projekt kompleks zërthehet në nën-projekte të cilat i marrim përsipër klasa të caktuar, kurse në këto klasa, detyrat shkojnë deri te nxënësi i veçantë.

Të 36 orët, që një nxënës ka detyrimin të punojë në projekte tilla, mund të realizohen brenda një viti shkollor ose të copëtohen në më shumë se një vit.

Këto orë janë të planifikuara për t'u zhvilluar në mjedise mësimore, nën drejtimin e drejtpërdrejt të mësuesit ose mësuesve dhe shënohen në regjistër po ashtu si orët e tjera mësimore.

Ekipi kurrikular cakton ngarkesën në orë mësimore të secilit mësues të përfshirë në një projekt të tillë.

- **Projektet kurrikulare si pjesë e përpunimit të njohurive**

Përveç përsëritjes së njohurive të një ose disa kapitujve, të cilat përdoren rëndom nga mësuesit për të përpunuar njohuritë e mësuara, edhe projekti kurrikular përdoret po për këtë qëllim. D.m.th. është një përsëritje e integruar, por ndryshon vetëm strategjia e përsëritjes. Projekte të tilla nuk kanë objektiva për përvetësimin e njohurive të reja. Në të vërtetë, kanë objektiva për njohuritë, por vetëm për përforsimin e atyre të mësuara më parë.

Kombinimi i njohurive të disa kapitujve të një lënde për të zgjidhur një situatë problemore, e sidomos, transferimi i disa njohurive nga një lëndë në një tjetër, dhe aq më shumë, duke i përdorur në një situatë reale, të gjithë këto i stërvitin nxënësit të kuptojnë më thellë konceptet dhe metodat kryesore të lëndëve.

Mësuesi duhet të veçojë e të rendisë ato njohuri të cilat ka për objektiva t'i përforsojë e thellojë nëpërmjet kësaj përsëritje të integruar që është projekti kurrikular.

Nxënësit, ndërsa kërkojnë e gjejnë informacione, hasen edhe me njohuri lëndore të cilat nuk i kanë mësuar më parë. Megjithatë nuk duhet t'u kërkohet nxënësve t'i mbajnë mend këto njohuri, dhe, sidomos, nuk duhet të vlerësohen me notë për to. Kurdoherë që ndodh është në kundërshtim me programet lëndore pasi tejkalojnë kufijtë e njohurive që ato kanë caktuar.

- **Numri minimal i orëve mësimore për projektet kurrikulare të planifikuara në programet lëndore**

Për secilën lëndë dhe secilën klasë, mësuesi duhet të planifikojë një numër orësh mësimore të cilat t'i kushtohen tërësisht projekteve kurrikulare të cilat synojnë përforsimin e njohurive.

Në tabelat më poshtë tregohet numri minimal i këtyre orëve brenda një viti shkollor. Mësuesi nuk është i shtrënguar të ndjekë pikë për pikë këtë tabelë. Shifrat e tabelave janë orientuese. Por, mësuesi nuk mund të planifikojë më pak orë nga sa janë shënuar në këto tabela. Sipas kushteve të nxënësve të tij dhe pikëpamjeve të tij të mësimdhënie-nxënies mund të planifikojë edhe më shumë orë nga sa tregohen në tabelë.

Tabela 1: Lëndët-bërthamë

Nr.		Numri minimal i orëve për projekte kurrikulare
1	Artet	6
2	Edukimi fizik	5
3	Gjuha e huaj	5
4	Gjuha shqipe	5
5	Aftësimi për jetën	6
6	Matematika	5
7	Kimia	5
8	Fizika	5
9	Biologjia	5
10	Shkenca e tokës	5
11	Qytetaria	6
12	Historia	5
13	TIK	5

Tabela 2: Lëndë me zgjedhje të detyruar

Nr.		Numri minimal i orëve për projekte kurrikulare
1	Gjuha e huaj	4
2	Trashëgimia jonë kulturore	18
3	Matematika e avancuar	5
4	Letërsia e avancuar	3+3
5	TIK-u i avancuar	3

Tabela 3: Lëndë/module me zgjedhje të lirë

Nr.		Numri minimal i orëve për projekte kurrikulare
1	Guida turistike	5
2	Njeriu dhe ndryshimet klimatike	4
3	Fotografia dhe fotoshopi	4
4	Lojrat sportive	3

Si rregull, një projekt kurrikular i tillë është punë grupi, ku grupi më i madh është e gjithë klasa, ndërsa më i vogli është një dyshe nxënësish, por, duhet të ketë edhe projekt i cili merret përsipër vetëm nga një nxënës. Këto të fundit kanë natyrën e një disertacioni. Udhëheqësi i këtij projekti mund të jetë edhe një pedagog i shkollave të larta. Nxënësi e mbron këtë projekt para një komisioni në nivel lokal ose qendror.

- **Planifikimi i projekteve kurrikulare në planin mësimor vjetor të mësuesit**

Projektet kurrikulare përfshihen në planin mësimor vjetor të secilit mësues po ashtu si kapitujt lëndorë. Mësuesi nuk është i detyruar që të paracakttojë të gjitha temat e projekteve kurrikulare qysh në fillim të vitit shkollor, madje këshillohet të mos e bëjë këtë. Nxënësit duhet të nxiten vazhdimisht të vrasin mendjen për tema projektesh, dora-dorës që lënda zhvillohet. Po ashtu dhe mësuesit u sjellin ndërmend nxënësve tema të mundshme.

Nga ana tjetër, disa projekte dalin papritur të nevojshme pas një ngjarje të spikatur komunitare, lokale, kombëtare ose botërore. Mësuesi e lë shtegun të lirë për këto raste në planin e vet lëndor.

Veprimtaria e nxënësit në një projekt kurrikular, ashtu si të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, ndahet në punë brenda klasës dhe punë jashtë saj.

Të gjitha orët mësimore, të cilat janë parashikuar për projekte kurrikulare, zhvillohen si orët e tjera lëndore, d.m.th. me të gjithë klasën, në praninë e mësuesit.

Me çfarë do të mbushen këto orë?

Disa orë mësimore janë të përbashkëta për çdo projekt kurrikular.

Të tilla janë orët për:

- T'u lehtësuar nxënësve gjetjen e temës (temave),
- Të këshilluar nxënësit gjatë zhvillimit të projektit,
- Të prezantuar nga nxënësit gjetjet e ndërmjetme të projektit,
- Të prezantuar përfundimin e projektit.

Një pjesë të mirë të punës me projektin nxënësit e zhvillojnë në klasë. Sidomos është shumë e rëndësishme që nxënësit të vijnë me pyetje për mësuesin.

Nxënësit porositen të demonstrojnë arritjet e ndërmjetme, p.sh. parashitjnë draft-planin e projektit.

Në këto orë mësimore kanë vende edhe të ftuarit, specialistë të temës së projektit burimorë ose bashkëpunëtorë të jashtëm në projekt dhe pyetjet e diskutimet me ta përbëjnë përmbajtjen e një ore mësimore.

Orët brenda në klasë shënohen në regjistër nga secili mësues krahas orëve të tjera të lëndës.

- **Projekte kurrikulare si metodë për përvetësimin e njohurive të reja**

Një ndër metodat, që vetë mësuesi e ka në dorë të zgjedhë, për të shtjelluar njohuritë e reja të parashikuara në programin lëndor, është edhe projekti kurrikular.

Këto janë projekte me përmasa më modeste se të tjerat dhe synojnë që t'i përfshijnë nxënësit në mënyrë më intensive dhe të motivuar në nxënien e disa njohurive. Nxënësit, nën drejtimin e mësuesit, përshkojnë rrugën e zbulimit "in vitro" të njohurive të reja nëpërmjet kërkimit të informacioneve dhe debateve në mes nxënësve.

Në kërkim të temave për projekte kurrikulare

- **Projekte me fund të hapur**

Vendosni para nxënësve një send të rëndomtë, p.sh. një copë letër. Nxitini të sajojnë sa më shumë pyetje rreth atij sendi.

Në një copë të thjeshtë letre është e fshehur një mori njohurish nga kimia, historia, gjeografia, ekonomia, matematika, edhe të tjera lëndë.

Disa pyetjeve, nxënësit mund t'u përgjigjen vetë aty për aty, për disa të tjera do t'u duhet të shfletojnë tekstet e tyre. Do të ketë pyetje të cilave mund t'u përgjigjen nxënësit duke qëmtuar informacione. Ka edhe nga ato të cilave ende nuk u është gjetur përgjigjja.

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup merr përsipër të kërkojë përgjigjet e disa pyetjeve.

"Sendi" mund të jetë mund të jetë një gjetje arkeologjike ose një linjë prodhimi, një zakon, si ai i dasmës, por edhe një personazh i zonës, kombëtar ose ndërkombëtar.

Përveç nxitjes së nxënësve për të bërë pyetje, e cila thuhetse mungon te disa mësues, mprihet aftësia e vëzhgimit të imtë.

Këto projekte janë me fund të hapur, që do të thotë se grumbullimi i informacionit dhe sistemimi i tij kanë për kufij afatin dhe zellin e të dyja palëve, të nxënëve dhe të mësuesve.

Projekti mund të jetë një-lëndor dhe në këtë rast "sendi" shqyrtohet nga pikëvështrimi i një lënde, por më shumë është ndër-lëndor.

- **Projektet kërkimore**

Tema mund të jetë përsëri një vëzhgim, por me qëllim që të zbulohet diçka që nuk dihej më parë. P.sh. vëzhgimi në udhëkryqet e qytetit nga nxënësit e një klase për të nxjerrë të dhëna se si i respektojnë rregullat e qarkullimit shoferët dhe këmbësorët, madje mund të mbajnë shënime për shkeljet nga këmbësorët sipas grup-moshave ose gjinisë. Ky është një studim që përfundon me tabela, edhe me diagrama.

Ftojnë një polic të trafikut qytetas dhe ai mund të rrëfejë shqetësimet e tij.

Si mund të lehtësohet trafiku? Si mund të pakësohen aksidentet? Këto janë tema për debate në mes nxënësve. Në fund, rekomandime, përherë, për përmirësime.

Po të kësaj natyre, dhe me mundësi të gjera, janë kërkimet brenda në shkollë, p.sh. për shijet e nxënësve, për marrëdhëniet në mes tyre e të tjera.

III. SHËRBIMI KOMUNITAR KRIJON AFTËSI TË SIPËRMARRJES

Shërbimi komunitar i nxënësit është veprimtari konkrete e kryer nga nxënësit, jashtë orarit mësimor, pa shpërblim financiar, në dobi të komunitetit.

Synimi i shërbimit komunitar është të përforcojë përgjegjësitë e nxënësit si individ i një komuniteti.

Objektivat e përgjithshme të shërbimit komunitar janë:

- Të formojë te nxënësit prirjen për vullnetarizëm si një qëndrim gjatë gjithë jetës;
- Të formojë te nxënësit prirjen për t'u përkujdesen për njerëzit në nevojë si një qëndrim gjatë gjithë jetës;
- T'i ndërgjegjësojë nxënësit rreth nevojave të komunitetit;
- T'i informojë nxënësit rreth përpjekjeve për kujdes social në komunitet;
- T'i bëjë nxënësit të ndihen të vlefshëm për komunitetin;
- Të japë përvoja të cilat u duhen nxënësve për jetën e përditshme dhe karrierën
- T'i informojë nxënësit rreth përpjekjeve në komunitet për kujdes social;

Te shërbimi komunitar përfshihen veprimtari në dobi të:

- Njerëzve në nevojë (të sëmurëve, të droguarve, handikapëve, jetimëve, të varfërve, të papunëve, të moshuarve, fëmijëve, etj.)
- Komunitetit (si ndotja e mjedisit, organizimi i veprimtarive sociale komunitare, etj.)

Shërbimi komunitar mund të kryhet:

- Pranë organizatave joqeveritare që zhvillojnë shërbime komunitare,
- Pranë qendrave publike të shërbimit komunitar,
- Në institucione të sektorit publik si spitale, azile, çerdhe, kopshte, shkolla, etj,
- Në komunitet, me miratimin e institucioneve shtetërore përkatëse (kryetari i komunës, kryeplakut i fshatit) për gjelbërimin, pastrimin apo mirëmbajtjen e një zone, për të ndihmuar familje të cilat nuk kane mundësi fizike të përballojnë nevojat e jetës së përditshme, etj.
- Në shkollën ku nxënësit mësojnë (p.sh. për hapjen e një ekspozite mbi një tematikë sociale me rëndësi për jetën e komunitetit, për ngritjen dhe mirëmbajtjen e një këndi sportiv, për krijimin dhe/ose mirëmbajtjen e një mjedisi të gjelbëruar, në formën e patronazhit me nxënësit e klasave më të ulta etj);

Nuk përfshihet te shërbimi komunitar pjesëmarrja në veprimtari:

- për biznese private,

- për pjesëtarë të familjes, për njerëz të afërt,
- ekstrakurrikulare të shkollës (si, konkurse, ndeshje sportive).

Gjatë tre viteve të gjimnazit secili nxënës duhet të kryejë gjithsej 18 orë shërbimi komunitar. Një orë shërbimi komunitar nga një nxënës llogaritet afërsisht me 1 orë veprimtari konkrete të nxënësit në shërbim komunitar.

Ndarja e orëve në vite bëhet sipas veçorive të veprimtarive. Nxënësi nuk është i detyruar të kryejë shërbim komunitar në çdo vit, megjithatë rekomandohet një shpërndarje e pak a shumë e njëjtë dhe, sidomos, të mos mbingarkohet viti i fundit i gjimnazit.

Në raste të veçanta, shërbimi komunitar mund të kryhet edhe gjatë pushimeve të verës. Orët llogariten për vitin paraardhës dhe nxënësi e merr dëftesën në vjeshtë.

Për informimin e nxënësve rreth shërbimit komunitar, shkolla planifikon në orarin mësimor 1-2 orë, të cilat organizohen në bazë klase, paraleleje ose më gjerë. Këtu ftohen përfaqësues të institucioneve, që përgjigjen ose ndërmarrin veprimtari të përkujdesjes komunitare, përfaqësues të qeverisë lokale, bashkisë ose komunave. Në takime të tilla rekomandohen të ftohen edhe prindërit.

Për shkëmbimin e përvojave dhe mbresave ndërmjet nxënësve rreth shërbimit komunitar planifikohen në orarin mësimor 1-2 orë në vit, të cilat organizohen, si rregull, në bazë klase, por nuk përjashtohet edhe më gjerë.

Nxënësit tregojnë për veprimtaritë e kryera, vlerat që ka pasur për ta, mbresa të veçanta, madje edhe sugjerime se si mund të përmirësohen. Bisedat duhet të jenë të lirshme jo si raportime.

Një nxënës mund të plotësojë orët e shërbimit komunitar vetëm me një veprimtari ose me disa veprimtari, të të njëjtit lloj ose të llojeve të ndryshme, në të njëjtin institucion ose në institucione të ndryshme.

Lloji i shërbimit komunitar, vendi ku do të kryhet dhe veprimtaritë përkatëse planifikohet nga nxënësi (nxënësit) në bashkëpunim me prindërit, shkollën dhe institucionin ose individët përfitues.

Është e rëndësishme të kihet parasysh që nxënësi është ai që zgjedh shërbimin komunitar. Nxënësi ndihmohet të zgjedhë nëpërmjet informacionit që i jep shkolla dhe nëpërmjet informacionit që siguron në rrugë vetjake dhe me ndihmën e prindit.

Shërbimi komunitar mund të organizohet me grupe të vogla nxënësish, individualisht ose me të gjithë klasën.

Prindi duhet të miratojë më shkrim përfshirjen e fëmijës së tij në një shërbim të caktuar komunitar. Shkolla duhet të informojë prindin për të gjithçka që ka të bëjë me shërbimin komunitar në tërësi dhe, në veçanti, për shërbimin që ka zgjedhur fëmija i

tij. Prindi ka të drejtë të propozojë për fëmijën e tij llojin e shërbimit komunitar ku mund të përfshihen edhe nxënës të tjerë.

Prindi ka të drejtë edhe të ofrojë falas lehtësira për kryerjen e shërbimit komunitar (p.sh. transportin, etj).

Një komision i shkollës për mbarëvajtjen e shërbimit komunitar përbëhet nga mësuesit, që përgjigjen për mirë-kryerjen e këtij shërbimi nga nxënësit dhe kryesohet nga një nëndrejtor ose drejtori i shkollës.

Komisioni:

- siguron për nxënësit informacion të mjaftueshëm për shërbimet e mundshme komunitare;
- shqyrton dhe miraton shërbimet komunitare, të propozuara nga vetë nxënësit/prindërit të cilat nuk përfshihen në listën e ofruar nga shkolla;
- harton një listë për shërbimet e mundshme komunitare dhe jua ofron nxënësve në formën e një menyje (përfshirë edhe propozimet e nxënësve/prindërve të miratuara);

Për mbarëvajtjen e veprimtarive të shërbimit komunitar, për një grup nxënësish, kryesisht mbi bazë klase, përgjigjet një mësues.

Mësuesi përgjegjës ka për detyrë:

- Të planifikojë dhe realizojë orët mësimore të shërbimit komunitar të cilat përfshihen në orarin mësimor;
- Të vëzhgojë mirë-kryerjen nga nxënësit të veprimtarive të planifikuara.
- Të shqyrtojë plotësinë dhe saktësinë e dëshmive për shërbimet komunitare të nxënësve.

Mësuesi ndjek veprimtarinë e nxënësve në vendet ku ata kryejnë shërbimet komunitare. Në ditarin e tij shënon qëllimin e vizitave, nxënësit, që do të vëzhgojë, përshkruan bisedat me përfituesit e shërbimit dhe konstatimet e veta për cilësinë e shërbimit nga nxënësit.

Mësuesi, dora-dorës, merr masa për të përmirësuar cilësinë e shërbimit komunitar për secilin nxënës.

Koha e punës së mësuesit për shërbimin komunitar përfshihet në ngarkesën zyrtare mësimore të tij dhe është gjithsej 36 orë për të tre vitet për një nxënës të një klase.

Gjatë kryerjes së veprimtarive të një shërbimi komunitar nxënësi plotëson portofolin e tij, i cili përmban këto zëra:

- Plani i shërbimit komunitar (synimin, përmbledhje e veprimtarive që do të kryejë)
- Përshkrimi i veprimtarive që ka kryer, përfituesit, kohën e zhvilluar,
- Përshtypjet e veta dhe të të tjerëve,
- Të tjera si fotografi, etj.

Të gjitha këto ia dorëzon mësuesit përgjegjës dhe i shërbejnë për të prezantuar në orët e shërbimit komunitar që organizohen në shkollë.

Për kryerjen e shërbimit komunitar, nxënësi nuk vlerësohet me notë.

Një shërbim komunitar i kryer nga një nxënës vërtetohet me një dëshmi sipas një formati standard. Një nxënës siguron aq dëshmi sa shërbime të ndryshme komunitare kryen.

Dëshmia firmoset nga një përfaqësues i institucionit përfitues të shërbimit dhe mësuesi përgjegjës. Kur shërbimi komunitar kryhet në shkollë, dëshmia firmoset nga një përfaqësues i drejtorisë dhe nga mësuesi përgjegjës.

Një nxënës e siguron një dëshmi kur ka plotësuar orët, që tregohen në dëshmi dhe e ka kryer shërbimin me cilësinë e synuar.

Nxënësi mund të mos e sigurojë dëshminë nëse përfaqësuesi i institucionit përfitues ose mësuesi nuk e firmosin atë. Në këtë rast personi, që nuk firmos, paraqet me shkrim zyrtarisht arsyet.

Nxënësi, që nuk siguron dëshminë, duhet ta përsërisë aq orë shërbimi komunitar sa nuk ka fituar. Për klasat e 10-të dhe 11-të, shërbimi mund të përsëritet në klasën pasonjëse. Për këto klasa nxënësi nuk konsiderohet mbetës kur nuk e merr dëshminë.

Shkolla mban një regjistër të veçantë për shërbimin komunitar, i cili hapet për nxënësit që fillojnë klasën e 10-të dhe të mbyllet në fund të klasës së 12-të. Aty shënohet periudha e kryerjes së këtij shërbimi nga secili nxënës në klasën 10,11,12 dhe vendi ku shërbimi është kryer. Këto të dhëna i hedh mësuesi përgjegjës për shërbimin komunitar bashkë me firmën e tij.

Për 18 orët e shërbimit komunitar nxënësi fiton 1/2 kredite.

Shënim

Përvojat e shërbimit komunitar mund të shërbejnë për tema projektesh kurrikulare, me kushtin që të jenë të lidhura me njohuritë e një ose disa lëndëve.

Më poshtë janë formularët që i takojnë shërbimit komunitar.

SHËRBIMI KOMUNITAR FORMULARI 1

Unë, prindi i nxënësit _____ jap lejen që fëmija im të kryejë shërbimin komunitar:

Në _____

Gjatë periudhës _____

Për

Unë marr përsipër _____

Data _____

Emri mbiemri

Firma

- **Udhëzues për plotësimin e formularit 1**

Formulari 1 plotësohet nga njëri prind i nxënësit para fillimit të një shërbimi komunitar.

Drafti i këtij formulari plotësohet nga nxënësi me ndihmën e mësuesit të shërbimit komunitar.

Formulari i plotësuar i dorëzohet mësuesit të shërbimit komunitar nga nxënësi ose prindi i tij.

Më poshtë janë udhëzime më të hollësishme të formulari 1.

**SHËRBIMI KOMUNITAR
FORMULAR 1**

Unë, prindi i nxënësit (*këtu shkruani emrin dhe mbiemrin e fëmijës tuaj*) jap lejen që fëmija im të kryejë shërbimin komunitar:

Në (Ku do ta kryejë fëmija juaj shërbimin komunitar. P.sh. te „Kryqi i Kuq”, „Azili i ...”, „Shoqata e mbrojtjes së fëmijëve”, etj.

Gjatë periudhës (*Këtu shkruhet zgjatja e shërbimit dhe orari i tij. Zgjatja tregohet p.sh. „Nga data 15. 10 deri më 07.12, vetëm në ditët e hëna dhe të mërkura. Orari tregon orët gjatë të cilave nxënësi kryhen shërbimin. P.sh 15.00-17.00*)

Për (*Këtu është përshkruar shkurt se çfarë do të bëjë nxënësi gjatë shërbimit komunitar*)

Unë marr përsipër (*Një prind mund të marrë përsipër çuarjen dhe sjelljen e fëmijës me automjet nga institucion, i ku kryen shërbimin komunitar, ose diçka tjetër*)

SHËRBIMI KOMUNITAR

DËSHMI

Nxënësi/ja _____

Ka kryer shërbim komunitar pranë _____

për _____

me _____ orë.

Shënim

Emri mbiemri

Firma

Emri mbiemri

Firma

- **Udhëzim për plotësimin e formularit.**

Te “Nxënësi/ja” shënohet emri i nxënësit, emri i të atit dhe mbiemri.

Ka kryer shërbim komunitar pranë (*Këtu shkruhet emri i plotë i institucionet pranë të cilit nxënësi ka kryer shërbimin komunitar*)

për (*Këtu përmbledhet lloji i shërbimit që nxënësi ka kryer*)

me (*Numri i orëve që i llogariten nxënësit*) orë.

Shënim

Përfaqësuesi i institucionit përfitues dhe/ose mësuesi i shërbimit komunitar mund të shtojnë komente të veçanta për punën e kryer nga nxënësi. Në fund të një komenti, autori vendos firmën e tij.

Ky zë e formularit mund të lihet i paplotësuar.

Dizajni i dëshmisë dhe prodhimi i tyre bëhet nga shkolla.

IV.LITERATURA E SHFRYTËZUAR:

- Kompetenca kyç për të nxënë të gjatë gjithë jetës. Raport i BE-së, Lisbonë 2004.
- Standardet e edukimit të sipërmarrjes. Ohajo. Sh.B.A 2004.
- Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, 2014. MAS
- Kurrikulat lëndore për klasat 1-9 dhe 10-12. Botime të IZHA. 2015.
- Standardet e të nxënit për fushat e të nxënit të parauniversitar. Botim i IKT, 2009

IV.1 WEBLIOGRAFI

- “Entrepreneurship Education at School in Europe National Strategies, Curricula and Learning Outcomes.” This document is published by the Education, Audiovisual and Culture Executive Agency (EACEA P9 Eurydice and Policy Support). 2012.
http://eacea.ec.europa.eu/education/eurydice/documents/thematic_reports/135en.pdf
- “Developing Key Competences at School in Europe.European Commission”2012.
http://eacea.ec.europa.eu/education/eurydice/documents/thematic_reports/145EN_HI.pdf
- “European Activities in Entrepreneurship Education” From Oslo 2006 to European Education & Training Strategy 2020. SIEC Denver Conference 2012.
<http://www.siec-isbe.org/uploads/8/9/6/2/8962951/p01.pdf>